



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 15.02.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-4249/22, për zyrtaren e lartë znj. Jehona Grantolli, Prokurore e Shtetit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi, për zyrtaren e lartë znj. Jehona Grantolli, Prokurore e Shtetit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës anonime të pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendime për konflikt të interesit, citojmë: “...për anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës Jehona Grantolli, e cila tani ushtron pozitën e Anëtares së Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe po e njëjta ushtron edhe pozitën e Udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë e zgjedhur në këtë pozitë që nga viti 2020 dhe vazhdon ende t’i ushtrojë këto dy pozita, gjatë kohës kur e njëjta mban edhe pozitën e anëtares së Këshillit[...]. Tutje në kërkesë thuhet se: *Është shqetësuese edhe mënyra se si po e njëjta anëtare Grantolli duke qenë anëtare e Këshillit, ia vazhdon vetës mandatin në pozitën e udhëheqëses së departamentit. [...]*”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me shkresën zyrtare DPKI-06-01/4853/22, e ka njoftuar zyrtaren e lartë znj. Jehona Grantolli lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar informacion/dokumentacion nga znj. Jehona Grantolli, të cilin e ka pranuar përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/4853-1/22.

Nga informacioni/dokumentacioni i dorëzuar në Agjenci nga znj. Jehona Grantolli, Agjencia ka konstatuar gjendjen si në vijim:

Me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr.: DP-004-216, datë 01.12.2016, znj. Jehona Grantolli është emëruar Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;

Me dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Nr.228/2019, datë 20.11.2019, znj. Grantolli është riemëruar Prokurore e Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr.165/2020, datë 15.04.2020, është caktuar Udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr.523/2020, datë 29.10.2020, është zgjedhur anëtare e Këshillit Prokurorial të Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar, duke filluar nga data 01/01/2021;

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/Nr.54/2021, datë 08.02.2021, znj. Jehona Grantolli i vazhdohet e mandati si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;

Nga procesverbali i takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, i datës 25.02.2021, konstatohet se vendimi (KPK/Nr.54/2021, datë 08.02.2021), është marr me dhjetë vota *për*, dhe një *abstenim* (Jehona Grantolli);

Në vazhdën e sqarimit të gjithanshëm të kësaj situate, është realizuar një takim me znj. Jehona Grantolli, në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë ballafaquar të gjitha faktet dhe informacionet që posedon Agjencia;

Sa i përket pozitës së udhëheqëses në Departamentin e Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, znj. Grantolli ka deklaruar se nuk merr asnjë lloj kompensimi monetar, pozita në fjalë nuk ka ende përshkrim të detyrave, ndërsa i raporton Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;

Ndërsa, sa i përket vazhdimit të pozitës si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm, znj. Grantolli ka deklaruar se, në procesverbalin e takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, i datës 25.02.2021, janë përvjedhur disa lëshime, sepse fillimisht në procesverbal nuk është cekur se disa nga anëtarët e KPK-së nuk kanë marrë pjesë fizikisht në këtë takim, por përmes platformës 'zoom', e një ndër to ka qenë edhe znj. Grantolli. Ndërsa sa i përket votimit sipas pikës 3. *Kërkesa për vazhdimin e pozitës së udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm [...]*, znj. Grantolli deklaron se nuk ka marr pjesë në votim dhe për këtë pos tjerash ka dëshmitare kolegen e saj, prokuroren B.A., sikurse mund të sigurohet edhe audio-incizimi i takimit në fjalë. Gjithashtu, e njëjta shton se, në procesverbalet e KPK-së edhe mosdeklarimi në votim, rëndom regjistrohet si abstenim, kjo edhe për faktin se rregullativa përkatëse e KPK-së, lë hapësirë interpretimi sa i përket votës abstenuese;

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga znj. Jehona Grantolli që lidhur me pretendimet për mundësinë e konflikt të interesit përkitazi me funksionet e saj në KPK dhe Prokurori, si dhe lidhur me pjesëmarrjen ose jo në votim me rastin e vazhdimit të mandatit si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, të dërgoj "Përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, informacionin se kujt i raporton në këtë cilësi", gjithashtu "Procesverbalin e korrigjuar të takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, të datës 25.02.2021, për sa i përket pikës 3. *Kërkesa për vazhdimin e pozitës së udhëheqësit*



të Departamentit të Përgjithshëm [...], konform gjendjes faktike, përkatësisht deklarimit të saj në takimin e mbajtur në Agjenci;

Në përgjigjen e znj. Grantolli sipas kërkesës së Agjencisë, theksohet se : “Sa i përket kësaj pozite nuk ka përshkrim të detyrave të punës pasi që sipas ligjit kjo pozitë nuk është pozitë ekzekutive apo vendimmarrëse dhe se për punën i raportoj Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i cili edhe bën vlerësimin vjetor të performancës për të gjithë Udhëheqësit e Departamenteve.

Ashtu siç kam theksuar në takim, kjo pozitë më tepër ka karakter të ndihmesës në punën e Kryeprokurorit dhe këto pozita janë paraparë siç mund të vëreni vetëm për Prokurorinë Themelore në Prishtinë, për shkak të numrit të madh të prokurorëve që ka kjo Prokurori dhe territorit të madh që mbulon në të gjithë Kosovën.

Ndërsa sa i përket pikës së dytë, ashtu siç ju kam sqaruar në takim, ditën kur është vendosur për propozimin e Kryeprokurorit K.M., për vazhdimin e mandatit të Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm, Jehona Grantolli, takimi është mbajtur në distance, për shkak të masave COVID19 dhe jo ashtu siç shkruhet në Procesverbalin që ju dispononi dhe unë kam qenë fizikisht në sallën e takimeve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, bashkë me prokuroren znj. B.S. Kjo do të mund të vërtetohet lehtë pasi që të nxirren dëshmitë për këtë takim, të cilat ju njoftoj që janë në fazën e grumbullimit. Ndërsa, sa i përket korigjimit të procesverbalit, kjo mbetet në kompetencën e Këshillit Prokurorial, prandaj deri atëherë, kërkoj mirëkuptim nga ana juaj! ”;

Më pas, znj. Jehona Grantolli, ka sjellë në Agjenci komunikimet me shkrim me u.d. Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së si dhe KPK-në përkitazi me lëshimin e ‘disa gabimeve teknike dhe përmbajtësore’ në procesverbalin e takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, të datës 25.02.2021, si dhe dokumentacion tjetër relevant rreth çështjes në fjalë;

Gjithashtu, pos dorëzimit të dokumentacionit, znj. Grantolli ka kërkuar që lidhur me ‘abstenimin’ në fjalë Agjencia ta ketë parasysh ‘Rregulloren nr.06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës’, si dhe ‘një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese (Rasti nr. KI34/17)’, ku trajtohet vota abstenuese;

Tutje, znj. Grantolli deklaron se ka siguruar gjithashtu audio-incizimin e takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, të datës 25.02.2021, ku me rastin e votimit në fjalë, ajo shton se, ‘nuk dëgjohet fare duke deklaruar votimin e saj’, ndërsa dëgjohet vetëm Kryeprokurori i shtetit duke konstatuar se, ‘vendimi në fjalë u mor me dhjetë vota ‘për’, dhe një ‘abstenim’ (znj. Jehona Grantolli)’, duke sugjeruar gjithashtu që rreth kësaj çështje të pyetet edhe (ish) Kryeprokurori i shtetit rreth deklarimit tim në atë takim.

Gjithashtu, ajo shton se në shkresat (emailat) në fjalë, mund ta gjeni kërkesën time drejtuar personave përgjegjës të KPK-së që t’i bëjnë korigjimet e nevojshme konform gjendjes faktike në procesverbalin e takimit të 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, i datës 25.02.2021.

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që fillimisht është konstatuar se ushtrimi i funksionit të anëtares së Këshillit Prokurorial (KPK), nga znj. Jehona Grantolli, krahas ushtrimit të funksionit të udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kjo për faktin se kufizimi i përcaktuar me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin përcaktohet se: *“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare [...]”*, nuk vlen në këtë rast, sepse funksionet e lartcekura që ushtron znj. Jehona Grantolli, janë funksione publike dhe nuk kanë të bëjnë me *person juridikë privatë* në kuptim të dispozitës në fjalë.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të raportuesit të rastit, lidhur me vazhdimin e mandatit të znj. Jehona Grantolli si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, duke u mbështetur në informacionin, dokumentacionin dhe deklaratat e znj. Jehona Grantolli, si dhe informacionin dhe dokumentacionin tjetër në dispozicion të siguruar nga KPK, bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe legjislacionit tjetër relevant, konstaton si në vijim:

Dokumentacioni i dorëzuar nga znj. Jehona Grantolli mbështetë deklaratën e saj me shkrim përmes komunikimit elektronik me Agjencinë, se, *‘ditën kur është vendosur për propozimin e Kryeprokurorit K.M., për vazhdimin e mandatit të Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm, Jehona Grantolli, takimi është mbajtur në distancë për shkak të masave COVID19 dhe jo ashtu siç shkruhet në Procesverbalin që ju dispononi dhe unë kam qenë fizikisht në sallën e takimeve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, bashkë me prokuroren znj. B.S.A’*.

Në shkresën elektronike të znj. Jehona Grantolli drejtuar u.d. Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, si dhe anëtarëve të KPK-së thuhet se, citoj: *“E them me përgjegjësi të plotë se personalisht në këtë takim kam marrë pjesë përmes platformës zoom dhe kam qenë fizikisht në Pallatin e Drejtësisë, Prokurorinë Themelore Prishtinë, në katin 1, në sallën e takimeve, bashkë me anëtarin e Këshillit znj. B.S.A. dhe kohën kur është diskutuar për këtë pozitë, unë kam kërkuar të dalë jashtë (të përjashtohem) nga votimi, (e di se ka pasur pengesa të theksuara teknike në këtë takim) dhe ka mundësi të mos jem dëgjuar, andaj për këtë të konsultohet znj. B e cila ka qenë prezente fizikisht me mua në sallë”*.

Ndërsa, sa i përket audio-incizimit nga takimi 195-të të KPK-së, nr. KPK/Nr. 129/2021, i datës 25.02.2021, lidhur me pjesëmarrjen ose jo në votim të znj. Jehona Grantolli, për vazhdimin e mandatit si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk është lëshuar në trajtimin teknik të kësaj prove, pasi që vlerëson se ky verifikim shkon përtej hetimit administrativ që zhvillon Agjencia, prandaj mbetet në deklaratën e znj. Jehona Grantolli dhënë në takimin e mbajtur në Agjenci, *‘e cila mohon pjesëmarrjen e saj në votim dhe se e njëjta deklaron se nuk dëgjohet në audio-incizim të jetë deklaruar fare me rastin e votimit për vazhdimin e mandatit të saj si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë’*.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me dispozitën e nenit 20, paragrafi 3, ka përcaktuar se: *“Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës”*.

Në këtë kontekst, neni 1, paragrafi 2 i Rregullores nr. 06/2019, për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokuroreve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, definojnë se:

“Kjo rregullore, gjithashtu, përcakton procedurën për caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokuroreve, Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit,

Zëvendëskryeprokurorëve, Udhëheqësve të Departamenteve dhe përfundimin e mandatit të Kryeprokurorëve”.

Neni 17, paragrafi 5 i rregullores në fjalë tek [Procesi i votimit] përcakton se:

“Nëse anëtari i Këshillit merr pjesë në takimin kur votohet për kandidatët dhe nuk voton për asnjërin kandidat, kjo do të konsiderohet si abstenim që ka vlerë vetëm për kuorum”.

Ndërsa, paragrafi 9 i po të njëjtës rregullore përcakton se:

“[...]Nëse anëtari i Këshillit nuk voton për asnjërin kandidat konsiderohet se ai/ajo ka abstenuar”.

Pra, dispozitat e sipërcituara të Rregullores në fjalë të KPK-së, përforcojnë deklaratat e zyrtares së lartë znj. Jehona Grantolli se ‘abstenimi’ në votimet e anëtarëve të KPK-së, jo domosdoshmërisht nënkupton pjesëmarrje apo deklaram përmes votimit.

Për më tepër, sipas procesverbalit të takimi 195-të të KPK-së, vendimi që znj. Jehona Grantolli t’i vazhdohet mandati si udhëheqëse e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, është marrë me shumicë absolute, përkatësisht *me dhjetë vota për*, dhe *një abstenim*, çfarë tregon se vota (eventuale) abstenuese në këtë rast nuk është përcaktuese në rezultatin final, e as nuk mund të konsiderohet si abstenim që ka vlerë vetëm për kuorum në kuptim të dispozitës më lartë.


Gjithsesi, me qëllim që në të ardhmen të shmanget mundësia eventuale e konfliktit të interesit, që ndërlihet me vendimmarrjen në raport me ushtrimin e funksionit të anëtares së KPK-së dhe udhëheqëses së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e njëjta duhet ta ketë parasysh konfliktin ‘rast për rast’ të interesit, ta deklaroj atë dhe të tërhiqet nga vendimmarrja, konform dispozitave vijuese të nenit 17 të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit:

1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.[...].

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit